VENDIM
Nr. 224, datë 10.7.2023

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 40, DATË 10.3.2022, "MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË 'LAJTHIZA INVEST' SHA NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC "QAMI 1", ME KAPACITET TË INSTALUAR 1.730 mw", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 53, pika 2, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; si dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.7.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 70/8 prot., datë 7.7.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 40, datë 10.3.2022, 'Mbi licencimin e shoqërisë 'Lajthiza Invest' sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC 'Qami 1', me kapacitet të instaluar 1.730 mw", i ndryshuar"',

konstatoi se:

· Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 40, datë 10.3.2022, i ndryshuar, me vendimin nr. 178, datë 18.5.2023, vendosi të licencojë shoqërinë "Lajthiza Invest" sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Qami 1", me kapacitet të instaluar 1.730 mw, për një afat 30-vjeçar, duke i lënë kushtin që të depozitojë në ERE lejen e përdorimit të burimit ujor të rinovuar jo më vonë se 3 muaj nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

· ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 1397 prot., datë 26.5.2022, duke i njoftuar ndryshimin e vendimit si më sipër dhe duke i evidentuar detyrimin për të depozituar në ERE Lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor.

· Me shkresën e protokolluar në ERE nr. 1397/3 prot., datë 30.5.2023, shoqëria depozitoi lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor për prodhimin energjisë elektrike nga HEC "Qami 1", me një afat 5-vjeçar, deri më 23.2.2028.

· Me depozitimin e këtij dokumenti, shoqëria ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 3 të vendimit nr. 40/2022, i ndryshuar, por duke qenë se kjo leje nuk mbulon të gjithë periudhën e licencimit dhe, po ashtu, i nënshtrohet rinovimit, vlerësohet që kjo pikë të ndryshojë, duke i lënë kushtin shoqërisë që të depozitojë në ERE lejen e rinovuar për përdorimin e burimit ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga HEC "Qami 1" brenda datës 23.2.2028.

· Në nenin 53, pika 2, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", parashikohet se: *përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, nëse ligji ose aktet nënligjore nuk parashikojnë një afat të caktuar për kryerjen e një veprimi procedural, organi publik që kryen procedurën cakton me vendim të veçantë një afat të arsyeshëm, sipas çështjes konkrete dhe në përputhje me parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit.*

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 3 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 40/2022, i ndryshuar, ndryshon dhe bëhet:

3. Shoqëria "Lajthiza Invest" sh.a. duhet të depozitojë në ERE lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga HEC "Qami 1" brenda datës 23.2.2028.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë "Lajthiza Invest" sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti